



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 373 Prot



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK
Nr. 2965 Prot

Akt marrëveshje

Në Tiranë, sot, më datë 24.08.2004, lidhet kjo akt-marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Ministria e Rendit Publik, i cili më poshtë do të quhet **MRP**, i përfaqësuar nga Ministri z. Igli Toska.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt-marrëveshje, me qëllim:

realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet anagazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. MRP anagazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive cdo informacion apo të dhënë që disponon ky institucion dhe ato të vartësisë, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

3. MRP do të caktojë një strukturë të posacme si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. MRP merr përsipër që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

5. ILDKP te vere ne dispozicion te dhenat, qe disponon, te kerkuara nga MRP ne interes te parandalimit dhe luftes kunder krimit te organizuar.

6. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 24 08.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Ministri

IGJITOSKA

